

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**BORDI DISIPLINOR**

**Nr. (•)i Vendimit**

**VENDIM**  
**BORDI DISIPLINOR**

i përbërë nga :

|                                 |                         |
|---------------------------------|-------------------------|
| <b>Jonida Gaba:</b>             | <b>Kryetare</b>         |
| <b>Entela Memishaj Shehaj:</b>  | <b>Sekretar/ Anëtar</b> |
| <b>Irena Laha:</b>              | <b>Anëtar</b>           |
| <b>Marjana Semini-Tutulani:</b> | <b>Anëtar</b>           |
| <b>Merita Prifti:</b>           | <b>Anëtar</b>           |

në seancat e datave (•), (•) dhe (•), mori në shqyrtim kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë sipas Urdhrit Nr. (•), Nr. (•)Prot, datë (•) të Ministrit të Drejtësisë, përcjellë me anë të shkresës Nr. (•)Prot, datë (•), me të dhënat si më poshtë:

**KËRKUES:** Ministria e Drejtësisë

**DREJTUAR:** Bordi Disiplinor, Dhoma Kombëtare e Noterisë

**KUNDËR:** Subjektit të Procedimit Disiplinor (•), Noter

**OBJEKTI:** Nisja e procedimit disiplinor për noterin (•); Marrjen e masës disiplinore të përcaktuar në gjurmën dh) të nenit 26 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”.

**BAZA LIGJORE:** Neni 26, 43-55 i Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”.

**BORDI DISIPLINOR**

pasi dëgjoi relatimin e Relatores znj. (•) dhe pasi përfundoi seancën dëgjimore me subjektin e procedimit disiplinor, Noter (•), përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësuar nga Znj. (•) dhe Z. (•) dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

1. Pranë Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë (“**Bordi**”), është depozituar më datë (•), shkresa me nr. (•)Prot., datë (•), e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë me objekt dërgimin për njohje dhe zbatim të Urdhrit Nr. (•), datë (•), të Ministrit të Drejtësisë “Për nisjen e procedimit disiplinor për noterin (•)”, për masën disiplinore të parashikuar në nenin 26, pika 2, gjërma “dh” të ligjit 110/2018 “Për noterinë”.
2. Me shkresën Nr. (•)Prot., datë (•), të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë është përcjellë pranë Bordit, edhe dokumenti Nr. (•)Prot., datë (•) “Raport mbi kryerjen e hetimit disiplinor pranë Noterit (•)” si dhe dokumentacioni i administruar nga grupi i punës në kuadër të hetimit disiplinor.

**A. MBI HETIMIN DISIPLINOR DHE SHKELJET E PRETENDUARA NGA MINISTRIA E DREJTËSISË**

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes hetimore rezulton se hetimi disiplinor është kryer nga Ministria e Drejtësisë në bazë të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. (•) Prot., datë (•) “Për fillimin e hetimit disiplinor pranë noterit (•)”, i cili disponon, ndër të tjera, që:

“Noteri z. (•) t’i nënshtrohet kontrollit me qëllim verifikimin e zbatimit të Ligjit Nr. 100/2018 “Për Noterinë”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë së noterëve, standarteve të sjelljes profesionale, në lidhje me kërkesën e paraqitur, nga Z. (•), si dhe regjistrimin e akteve/veprimeve noteriale në sistemin RNSH për periudhën (•)-(•)”.

4. Sipas urdhrit të mësipërm, rezulton se hetimi disiplinor ka marrë shkas nga kërkesat e z. (•) (respektivisht, datë (•), (•) dhe (•)), i cili ka pretenduar se noteri në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi refuzon të hartojë procesverbalin e testamentit lëshuar më datë (•) nga i ndjeri z. (•) pranë zyrës së tij noteriale me qëllim çeljen e dëshmisë së trashëgimisë nga noteri ku është depozituar testamenti i fundit nga i ndjeri sipas parashikimeve të pikës 1 dhe 2 të nenit 120 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”.

5. Faktet mbi të cilat ka nisur hetimi disiplinor janë si më poshtë përmbledhur:

5.1. Pranë Ministrisë së Drejtësisë, është protokolluar shkresa e kërkesit (•), me Nr. (•) Prot., datë (•), me anë të së cilës pretendon se noterja (•), është duke vepruar në kundërshtim me ligjin, për shkak të mosveprimit të saj për Çeljen e Dëshmisë së Trashëgimisë, për vëllain e tij, të ndjerin (•).

5.2. Me shkresën nr. (•) Prot., datë (•), Ministria e Drejtësisë i është drejtuar noterës (•), ku i kërkon informacion mbi kërkesën e Z. Pashk Nokaj.

5.3. Me shkresën nr. (•) Prot., dt. (•), të protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë Notere (•), i është përgjigjur Ministrisë së Drejtësisë, se sipas informacionit të marrë prej saj pranë DHKN, rezulton se trashëgimlënësi (•), ka lënë tre testamente, konkretisht pranë noterëve:

- Noteri: (•) datë (•);
- Noteri: (•) datë (•);
- Noteri: (•) datë (•);

5.4. DHKN në kthim përgjigjen e kërkesës me nr. (•), midis të tjerave e informon noterën (•) se:

“Ju mund të vijoni me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin (•)..., pasi të keni marrë në dorëzim procesverbalet e çeljes së testamentëve pranë noterëve të sipërcituar, meqënëse Ju jeni Noteri që dispononi testamentin e fundit të lënë nga Trashëgimlënësi gjatë gjallërisë së Tij”..

5.5. Sa më sipër, Notere (•), ka informuar Ministrinë e Drejtësisë se nuk mund të vijojë procedurën, pasi nuk i janë vendosur në dispozicion procesverbalet e dy noterëve të tjerë.. sikurse parashikon ligji nr.110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar, neni 120, pika 1.

5.6. Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. (•) Prot., datë (•), ka orientuar shtetasin (•), për të paraqitur kërkesë për hartimin e procesverbalit të çeljes së testamentit, para noterit (•) dhe noterit (•), pranë të cilëve janë lënë dy testamentet e tjerë, nga i ndjeri (•). Kjo me qëllim dorëzimin e një kopjeje të secilit prej procesverbaleve tek notere (•), e cila, si noterja ku është depozituar testamenti i fundit nga trashëgimlënësi, duhet të vijonte me Çeljen e Dëshmisë së Trashëgimisë.

- 5.7. Pranë Ministrisë së Drejtësisë është protokolluar shkresa me nr. (•), datë (•), e z. (•), me të cilën pretendohet se:
- është paraqitur pranë zyrës së noterit z. (•), me kërkesën për hartimin e Procesverbalit të Çeljes së Testamentit datë (•), të të ndjerit (•);
  - Është përballur me kundërshtimin e noterit për hartimin e këtij procesverbali.
- 5.8. Ministria e Drejtësisë me shkresën me nr. (•), datë (•), i ka kërkuar informacion noter (•) mbi arsyet e mos hartimit të procesverbalit të çeljes së testamentit nga ana e Tij. Noteri nuk ka kthyer përgjigje.
- 5.9. Ministria e Drejtësisë ka kërkuar sërish informacion me shkresën nr. (•) prot., datë (•), kërkesë e cila i është përcjellë edhe në rrugë elektronike noterit, me e-mail të datës (•) dhe në përgjigje të këtij emaili, noteri ka shkruar:

*“Sipas ligjit për noterinë 110/2018 unë i jam përgjigjur kërkesës tuaj dhe kërkesës së Noteres Znj. (•) për dërgimin e dëshmisë testamentare. Qytetari (•) i është dhënë përgjigje që kopjen e dëshmisë testamentare dhe dëshmisë të trashëgimisë ligjore ta tërheqë pranë notere (•). Kjo kopje ndodhet pranë Noteres (•).*

*Z. (•) nuk është palë në akt të noterisë si dhe të drejtat dhe detyrimet nuk janë për atë në testament. Për gjithçka Z. (•) t’i drejtohet djalit të xhaxhit (kushëririt të tij të parë) për tërheqjen e dëshmisë testamentare, t’i drejtohet Gjykatës ose Prokurorisë, ose noterisë e cila ka çelur dëshminë e trashëgimisë ligjore pra tek Znj. (•) pasi unë e kam pajisur me kopje të dëshmisë testamentare sipas ligjit.<sup>1</sup>”*

- 5.10. Me shkresën (•) Prot., date (•) të z(•), Ministria e Drejtësisë, është vënë në dijeni se noteri vijonte të mos hartonte Proces Verbalin e Çeljes së Testamentit, duke penguar ankuësin në procesin gjyqësor civil ku i kërkohet dëshmia e trashëgimisë, për të kryer zëvendësimin procedural për disa palë ndërgjyqese që kanë ndërruar jetë.
6. Në vijim të sa më sipër, Ministri i Drejtësisë ka nxjerrë Urdhrin nr. (•), datë (•) “Për fillimin e hetimit disiplinor pranë noterit (•)”, përmes së cilit urdhëron ushtrimin e kontrollit në zyrën noteriale të noterit (•). Në zbatim të këtij Urdhri, nëpunësit e ngarkuar nga Ministria e Drejtësisë ushtruan kontroll në zyrën noteriale të noterit (•) më datë (•).
7. Nga grupi i kontrollit të Ministrisë së Drejtësisë u kryen veprimet hetimore, nga të cilat, sipas Raportit për Kryerjen e Hetimit Disiplinor Nr. (•) Prot, datë (•), të Ministrisë së Drejtësisë (“**Raporti Hetimor**”), ka rezultuar si më poshtë :

#### **I. Shkelja Nr. 1: Mungesa e përdorimit të RNSH**

8. Sipas Raport Kontrollit, në faqe 6 dhe 7, rezulton se pas verifikimit nga ana e grupit të kontrollit konstatohet se sistemi RNSH është instaluar nga ana e noterit, por nuk është përdorur në mënyrë të rregullt dhe sistematike nga ana e tij. Në zbatim të pikës 1, të Urdhrit për Fillimin e Hetimit disiplinor, grupi i inspektimit realizoi verifikimin e hedhjes së akteve dhe veprimeve noteriale në sistemin e RNSH- së, për periudhën (•)–(•), ku u konstatua se noteri ka hedhur **akte deri në datën (•)**. Nga ana e noterit u shpreh fakti se:

<sup>1</sup> Fq. 9 e raportit të Ministrisë së Drejtësisë.

*"aktet janë hedhur në sistemin NISA, por pjesën e RNSH-së, periudha e pahedhur e akteve dhe veprimeve noteriale përkon me faktin se për arsye të tërmetit në qytetin e (•), noteri ka ndryshuar zyrë 3 (tre) herë".*

Gjithashtu, nga ana e grupit të kontrollit u administrua dhe *print screen* i veprimeve të fundit të realizuara në sistemin NISA, i cili është shprehur se sistemi përdorej në mënyrë të rregullt nga noteri.

9. Hedhja e akteve është bërë deri më datë (•), duke pasur parasysh se verifikimi në sistemin RNSH, u bë më datë (•), në referim të prononcimit. Referuar detyrimit që moshedhja e akteve apo veprimeve noteriale në sistemin "NISA" përbën shkelje edhe referuar parashikimeve të bazuara në pikën 13 dhe 14 të VKM-së nr. 1045, datë 15.01.2020, "Për Mënyrën e Ndërlidhjes, Nivelin e Aksesit dhe të Bashkëveprimit të Sistemit Elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë me Bazat e tjera të të Dhënave", (sistemi "NISA", i DHNK), ku çdo noter duhet të sigurojë regjistrimin e veprimeve dhe akteve noteriale në Regjistrin Noterial Shqiptar. Nga raporti i grupit të inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë derivon konkluzioni që noteri ka shkelur detyrimin ligjor që buron nga dispozitat e mësipërme.

## **II. Shkelja Nr.2.: Shkelje në hartimin dhe çeljen procesverbalit të çeljes së testamentit dhe lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare**

- Noteri (•) nuk ka përmbushur kërkesat e nenit 111, 113 të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë" dhe nenit 348 të Kodit Civil.

10. Konstatohet se noteri nuk ka plotësuar kërkesën kryesore për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë. Konkretisht nuk ka dërguar një kërkesë pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë, së cilës duhet t'i bashkëlidhte edhe një kopje të kërkesës së personit të interesuar dhe një kopje të certifikatës së vdekjes së trashëgimlënësit, sipas pikës "b" e në vijim të nenit 111 "Kërkesa për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë", të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar, ku theksohet se: *"Noteri dërgon një kërkesë pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë, së cilës i bashkëlidh një kopje të kërkesës së personit të interesuar dhe një kopje të certifikatës së vdekjes së trashëgimlënësit, për të verifikuar nëse trashëgimlënësi ka lëshuar testament apo ka dëshmi tjetër trashëgimie të regjistruar. Pas marrjes së kërkesës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, brenda 3 ditëve, kontrollon në Regjistrin Kombëtar të Testamenteve dhe Regjistrin Kombëtar të Dëshmive të Trashëgimisë nëse trashëgimlënësi ka lënë një testament dhe/ose është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore apo testamentare nga ndonjë noter tjetër. Brenda 3 ditëve pas marrjes së përgjigjes nga Dhoma, noteri:*

*a) drejton personin e interesuar te noteri, i cili ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë ose pranë të cilit është hartuar testamenti, nëse ka;*

*b) procedon me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore ose testamentare, në përputhje me parashikimet e Kodit Civil, dhe e regjistron atë në Regjistrin Kombëtar të Dëshmive të Trashëgimisë.*

11. Në rastin objekt inspektimi, noteri (•) nuk ka zbatuar parashikimet e nenit 111, pikat 1 dhe 2, dhe nenit 113, duke dhënë "Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare me nr. (•), nr. (•), datë (•)", pa bërë verifikimin e procedurës ligjore parashikuar në këto dispozita.

- Noteri (•) nuk ka përmbushur kërkesat e nenit 120 të Ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë":

12. Referuar nenit 120 "Procedura e lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë kur ka më shumë se një testament", në rastet kur testatori ka lënë më shumë se sa një testament në noterë të ndryshëm, secili noter, mbi bazën e kërkesës së trashëgimtarit testamentar/ligjor ose personit të interesuar, duhet detyrimisht të hartojë procesverbalin e çeljes së testamentit. Të gjitha testamentet duhet të çelen nëpërmjet procesverbalit, për të proceduar me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë Testamentare, vendim të cilin e jep noteri që ka hartuar

ose tek i cili është depozituar testamenti i fundit i trashëgimlënësit. Një kopje e procesverbalit të çeljes së testamentit të secilit noter i jepet kërkuesit, i cili duhet ta paraqesë atë te noterit që ka hartuar apo ku është depozituar testamenti i fundit dhe që do të lëshojë dëshminë e trashëgimisë, sipas parashikimeve të Kodit Civil.

13. Nga materialet e administruara nga grupi hetimit të Ministrisë së Drejtësisë, nuk rezulton asnjë akt bashkëlidhur "Vendimit për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare (•), (•), datë 17.12.2020", që konkretisht është përgjigje nga Dhoma Kombëtare e Noterisë si dokument provues mbi hetimet e realizuar prej noterit (•), i cili ka vepruar duke vijuar me dhënien e një vendimi, për të cilin nuk është noterit që ka hartuar ose ku është depozituar testamenti i fundit, vendim të cilin duhet ta kishte dhënë pra në rastin në shqyrtim nga noterja (•).
14. Gjithashtu nga verifikimet e bëra në Regjistrin Noterial Shqiptar (RNSH), më 25.02.2022, rezulton se i ndjeri Gjergj Nikoll Noka ka lënë testament në 3 (tre) noterë përkatësisht tek noterit (•) më datë 23.10.2019, tek noterit (•) më datë 02.07.2020 si dhe tek noterja (•) më datë 23.11.2020.
15. Në lidhje me këtë pikë, Raporti i Ministrisë së Drejtësisë, në faqen 12, flet për pasojat e dëshmisë testamentare të lëshuar nga noterit (•), pasi kjo është rregjistruar në rregjistrat e pasurive të paluajtshme.
  - Noteri (•) nuk ka përmbushur kërkesat e nenit 105, pika 2, gërma "dh" të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë":
16. Konstatohet se mungojnë kartat e identitetit të z. (•), në kundërshtim me nenin 105 të Ligjit Nr. 110/2018 "Për noterinë". Në procesverbalin me (•), dhe (•), datë (•), mungojnë kartat e identitetit të trashëgimlënësit të ndjerit (•) si dhe personit trashëgimtar, kërkesa mbi bazën e së cilës trashëgimtarit testamentar/ligjor ose personi i interesuar paraqitet tek noterit duke vepruar në kundërshtim me pikën 1 të nenin 118 "Procesverbali i çeljes së testamenteve", ku theksohet se:

"Testamenti me akt noterial dhe ai ollograf çeljet nga noterit që e ka hartuar mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga trashëgimtarit testamentar/ligjor ose personi i interesuar. Trashëgimtarit testamentar, ligjor apo personi i interesuar, duhet të paraqesë para noterit kërkesën, certifikatën e vdekjes së trashëgimlënësit dhe dokumentin identifikues të kërkuesit".

Gjithashtu në Vendimin për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare (•) Rep., nr. (•) Kol., datë (•), ku bashkëlidhur është Testamenti me nr. (•) Rep., dhe (•) Kol., mungon karta e identitetit të trashëgimlënësit Testatorit (•).

### **III. Shkelja Nr. 3: Noteri (•) nuk ka përmbushur detyrimin për t'iu përgjigjur me shkrim kërkuesit (•), në kuptim të nenit 97 të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë"**

17. Referuar procesverbalit të datës (•), ku noterit ka deklaruar se i është përgjigjur verbalisht ankuesit (•), Ministria e Drejtësisë sjell në vëmendje se janë persona të interesuar ata që kanë të drejtë të kërkojnë lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë trashëgimtarët testamentarë, ligjorë dhe personat e interesuar të çmuar si të tillë nga noterit, pas një kërkesë me shkrim të arsyetuar. Janë persona të interesuar çdo person fizik ose juridik, ose përfaqësues i tij, që pas vdekjes së trashëgimlënësit provojnë se kanë një interes të ligjshëm për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë. Me persona të interesuar kuptojmë institucionet publike apo private, përbaruesit që kanë një procedurë ekzekutimi të detyrimit, institucionet gjyqësore, ose çdo individ apo subjekt fizik ose juridik, ose përfaqësuesi i tij, të cilët, pas vdekjes së trashëgimlënësit, provojnë, nëpërmjet

paraqitjes së një kërkesë arsyetuese, se kanë një interes të ligjshëm për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë apo çeljen e procesverbalit të testamentit.

#### **IV. Shkelja Nr.4: Noteri (•) ka një vulë që nuk duket mirë**

18. Kjo shkelje është pjesë vetëm e konkluzioneve pa ndonjë analizë dhe nuk do të trajtohet në vijim.

#### **B. QËNDRIMI DHE ARGUMENTET MBROJTËSE TË NOTERIT, LIDHUR ME SHKELJET E PRETENDUARA**

19. Në dy seancat dëgjimore të mbajtura përpara Bordit Disiplinor, në prani të Noterit (•), përfaqësuesi të tij ligjor, Av. (•), dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë sipas nenit 47 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, Bordi Disiplinor u njoh me qëndrimin dhe argumentat mbrojtëse të Noterit (•), të depozituara paraprakisht edhe me shkrim nga avokati mbrojtës i tij. Noteri i kërkoi Bordit të rrëzojë kërkesën e Ministrit të Drejtësisë sipas Urdhrit nr. (•), date (•) për shkak se faktet nuk kanë ndodhur ose nuk përbëjnë shkelje të rënda, duke paraqitur **argumentat mbrojtëse si vijon:**

19.1. Për fillimin e hetimit disiplinor është ndjekur një procedurë e gabuar nga Ministri i Drejtësisë; raporti tejkalon objektin e hetimit, referuar Urdhrit nr. (•), date (•). Shkaku i hetimit dhe i fillimit procedural disiplinor nuk është bërë konform ligjit dhe Urdhrit të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 408, datë 03.12.2020 “Për miratimin e standardeve dhe metodologjisë së inspektimit të veprimtarisë së noterit”. Para se të shkohet në masën më ekstreme disiplinore, si ajo e propozimit të heqjes së liçencës së noterit, ligjit kërkon të ndiqet një procedurë mjaft e kujdesshme, e cila në këtë rast nuk rezulton e tillë.

19.2. Vetë ligji ka përcaktuar kushtet apo rastet se kur mund të ushtrohet kontroll ndaj noterit. Ministri mund të fillojë një hetim disiplinor nëse konstatohen parregullsi gjatë kontrolleve periodike që ushtrohen ndaj noterëve (neni 25/1). Ai mund ta fillojë atë kryesisht kur nga burime të besueshme dalin të dhëna thelbësore nga ku lindin dyshime të arsyeshme se është kryer shkelje disiplinore (neni 25/2 dhe 30). Së fundi, procedimi mund të fillohet mbi bazën e kërkesë-ankesave nga subjekte të ndryshme (neni 29/1). Në këtë rast, objekti i hetimit duhet të bazohet në objektin e ankimit.

19.3. Rezulton se Ministri i Drejtësisë e ka filluar hetimin disiplinor mbi bazën e kërkesës së qytetarit (•) (neni 29/1), me shkakun e mosdhënies akses këtij personi mbi aktet testamentare, që në Urdhrit Nr. 644, datë 24.11.2021, formulohet me termat “kontroll mbi sjelljet sipas standardeve profesionale në kërkesat e qytetarit (•)”. Por, Ministri nuk mund të fillojë procedim për çdo ankim të paraqitur, pasi kështu veprimtaria noteriale është e diskriminuar. Ministri duhet të kishte bërë lidhjen mes pretendimit të kërkuarit dhe të drejtës të cënuar nga noteri, të cilën nuk e ka kryer.

19.4. Subjekti ankues Pashk Noka nuk gëzon legjitimitim për ankim, prandaj nuk ka vend për hetim ndaj sjelljeve sipas standardeve profesionale. E drejta për akses në aktet noteriale nuk i përket cilitdo personi por vetëm atij që ka interes mbi aktet dhe veprimet noteriale. Nga aktet që i paraqiten Bordit, rezulton se ankuesi është vëllai i testatorit, si i tillë, në prani fëmijëve dhe pasardhësve të tij (neni 377 Kodi Civil), ai nuk legjitimohet si trashëgimtar testamentar i domosdoshëm për të marrë informacion pasi nuk ka asnjë interes të ligjshëm të drejtpërdrejtë. Në këtë kuptim, konsiderimi si shkelje disiplinore, për mosrespektim të kërkesave të qytetarit Pashk Nokaj sipas standardeve profesionale, është sa i gabuar aq dhe i padrejtë.

19.5. Raporti shkel një procedurë të rëndësishme hetimi disiplinor, pasi tejkalon ndjeshëm objektin e hetimit duke kontrolluar edhe veprimet e noterit në çeljen e testamentit dhe lëshimin e dëshmisë së

trashëgimisë testamentare, kur në Urdhrin Nr. 644, date 24.11.2006, verifikimi i këtyre akteve nuk ishin objekt hetimi.

- 19.6. Pamvarësisht nga sa më sipër, nuk ka cënim të ligjit dhe nga shkelja e konstatuar nuk ka dëm, për të shkuar në masë ekstreme, në kuptim të nenit 26/3/c të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”. Në Raport, ashtu dhe gjatë seancës dëgjimore nuk bëhet dallimi i shkeljes disiplinore që të klasifikohet e rëndë për masë të rëndë disiplinore. Per fillimin e procedimit disiplinor me kërkesë për heqje liçence, minimalisht duhet të provohej shkalla e shkeljes që përcaktohet nga përsëritja, qëllimi dhe dëmi. Provohet se noteri (•) nuk është përsëritës, nuk i ka kryer veprimet me qëllim përfitimi, dhe nuk i ka shkaktuar askujt dëm. Po ashtu, mangësitë në procedurat e ndjekura nga noteri në çeljen e testamentit dhe lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare, nuk janë shkelje të rënda disiplinore. Asnjë dëm nuk i ka ardhur të tretëve. Si përfundim, vlerësimi si shkelje e rëndë disiplinore i mospërmbushjes së kërkesave të ligjit për verifikimin e testamenteve të mëvonshëm, është i pavend, sipas subjektit të procedimit, pasi duke mos pasur dëm, mosverifikimi i lëshimit të testamenteve të tjera konsiderohet shkelje disiplinore, por kurrësesi e rëndë.
- 19.7. Raporti bazohet në një akt nënligjor të pa botuar në Fletori Zyrtare, konkretisht, Urdhri nr. 4, datë 07.01.2020 i Ministrisë së Drejtësisë; si rrjedhojë, edhe Ministri në propozimin për masën mbështetet në një akt nënligjor të pa botuar në Fletoren Zyrtare.
- 19.8. Mungesat dhe vonesat e regjistrimit të disa akteve dhe veprimeve noteriale në regjistrin e RNSH në (•)- (•), dhe në sistemin NISA (•), në kuptim të nenit 26 të ligjit, nuk duhet konsiderohen as si shkelje e jo më të rënda. Dihet se sot Noteri administron dhe plotëson në mënyrë manuale tre regjistra: të përgjithshëm, të testamenteve dhe atë të ruajtjes së letrave me vlerë. Ndërkohë, pas vitit (•), ai i regjistron aktet dhe veprimet noteriale edhe në regjistrin elektronik RNSH, dhe pas (•) (definitivisht pas (•)) në regjistrin e DHKN, NISA. Po ashtu ai regjistron në Regjistrat Kombëtar respektivë testamentet dhe dëshmitë e trashëgimisë. Regjistrat noteriale janë akte shumë të rëndësishme unikalë pasi jo vetëm evidentojnë veprimtarinë por edhe e regjistrojnë atë sipas kronologjisë së kryerjes së tyre, duke mos lejuar kështu hartimin e akteve me datë të mëparshme nga realiteti, si dhe shmangin abuzimet pa fund që kanë qenë të zakonshme deri pak kohë më parë.
- 19.9. Ministri ka dhënë opinion se jemi para një noteri të rregullt në plotësimin dhe administrimi i regjistrave manualë, ndërsa e konsideron shkelje apo parregullsi të rëndë mos regjistrimin e akteve në RNSH. Por, prej Ministrisë në këto dy vitet e fundit mosregjistrimi në kohë i akteve dhe veprimeve noteriale në regjistrat elektronik nuk është konsideruar si shkelje e rëndë disiplinore. Pra, ai për këtë hetim nuk ndoqi një procedurë korrekte si dhjetra raste analoge dhe shumë më flagrante se sa ajo e (•).
- 19.10. Nga aktet e paraqitura si prova zyrtare nga noteri, rezulton se nuk ka mangësi të përsëritura apo të shpeshhta në mos regjistrimin e akteve në regjistrat elektronik të RNSH dhe më pas tek NISA, përfundim që vjen ndesh me konstatimet e Ministrisë.
- 19.11. Në Raport shënohen dhe fakte të pavërteta me qëllimin për të shkuar në shkelje disiplinore. Sipas Raportit, mungojnë akte shoqëruese të domosdoshme në çeljen dhe lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare, si certifikatë vdekje, lindje etj., apo se vula e njomë nuk ishte e qartë, fakte këto që rezultojnë të ndryshme nga sa shkruhet. Në raport shënohet edhe fakti se noteri paska marrë (•) vjet më parë (•), një vërejtje, kur dihet që me kalimin e 3 viteve (sot 5) sipas ligjit masat vetë shuhen, pra asesi ai nuk konsiderohet përsëritës.

## C. VLERËSIMI I BORDIT

### **C.1. Në lidhje me procedurën disiplinore të ndjekur**

20. Bordi Disiplinor vlerëson se në kuptim të neneve 26, 41, 43 e vijues të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë" janë kushtet për fillimin dhe vijimin e procedurës disiplinore sipas Urdhrit Nr. (•), Nr.(•)Prot, datë (•) të Ministrit të Drejtësisë, sipas të cilit, në kuptim të gërmës dh) të nenit 26 të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë", urdhërohet nisja e procedimit disiplinor për Noterin (•).
21. Bordi Disiplinor vlerëson se sipas nenit 44 të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë", nuk janë kushtet për të mbyllur procedimin disiplinor, në kuptim të paragrafeve a), b) dhe c).
22. Seanca disiplinore është mbajtur si seancë publike, tre të tilla, dhe përbërja e Bordit Disiplinor ka qenë e plotë, në përputhje me parashikimin e nenit 42, paragrafi 11 të të njëjtit ligj dhe në përputhje me nenin 11 të Ligjit Nr. 8480 datë 27.05.1999 "Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike".
23. Fillimi i procedurës disiplinore ndaj Noterit (•) ka nisur nga Ministri i Drejtësisë, në kuptim të nenit 41 të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë". Ministri i Drejtësisë ka nxjerrë Urdhrin nr. (•), datë (•), sipas të cilit, urdhërohet nisja e procedimit disiplinor për noterin (•) për masën disiplinore të parashikuar në gërmën dh) të nenit 26 të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë". Ky urdhër bashkërisht me Urdhrin Nr. (•), Nr. (•)Prot, datë (•) "Për Fillimin e Hetimit Disiplinor pranë Noterit (•)", Raportin mbi Kryerjen e Hetimit Disiplinor pranë Noter (•) me Nr. (•)Prot, date (•), si dhe me dosjen e plotë hetimore i janë përcjellë rregullisht Bordit Disiplinor.
24. Nga Raporti i Hetimit dhe dosja hetimore e përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, rezulton se hetimi për shkeljen e pretenduar është kryer brenda afatit ligjor (6 muaj) nga marrja e vendimit për fillimin e hetimit. Konkretisht, është nxjerrë Urdhri për Fillimin e Hetimit Disiplinor pranë Noterit (•), Nr. (•), Nr.(•)Prot, datë (•). Grupi i kontrollit ka ushtruar kontroll pranë Noterit (•) në datën (•).
25. Shkeljet e konstatuara nga Raporti Hetimor, në bazë dhe për shkak të të cilës, Ministri i Drejtësisë kërkon zbatimin e pikës dh) të nenit 26 të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë": heqje përfundimtare e licencës për ushtrimin e profesionit të noterit për Noterin (•), është : mungesa e përdorimit të RNSH, në kuptim të VKM nr. 304, datë 21.05.2014; Shkelje në hartimin dhe çeljen procesverbalit të çeljes së testamentit dhe lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare, në kuptim të nenit 111, 113, 120, 105, pka 2 të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", nenit 348 të Kodit Civil; Dështimi për tu përgjigjur me shkrim ndaj kërkuesit (•), në kuptim të nenit 97 të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë". Sipas këtij Raporti, këto, konsiderohen shkelje shumë të rënda në kuptim të ligjit dhe akteve nënligjore të mësipërme.
26. Me qëllimin analizimin e shkeljeve si më sipër, sjellim paraprakisht parashikimin e nenit 26 të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë", sipas të cilit masa disiplinore e dhënë ndaj një noteri jepet në proporcion me shkeljen dhe bazohet në kriteret e mëposhtme:
  - a) shkallën e pakujdesisë;
  - b) shpeshtësinë e kryerjes së gabimit;
  - c) probabilitetin dhe rëndesën e dëmit të mundshëm nga shkelja;
  - ç) çdo situatë që është jashtë kontrollit të noterit dhe që mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme.

### **C.2. Në lidhje me kërkesat dhe pretendimet e palëve**

27. Bordi Disiplinor pasi analizoi me kujdes faktet, bazën ligjore dhe raportin e Ministrisë së Drejtësisë, dhe pasi dëgjoi parashtrimet e subjektit të procedimit, noterit (•) dhe të përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë në seancat dëgjimore.



## Vlerëson se:

### **C.2.1. Diskrecioni në Urdhrat e Ministrit të Drejtësisë**

28. Në lidhje me pretendimin e Noterit (•) se Ministri Drejtësisë nuk mund të fillojë procedim për çdo ankim të paraqitur, pa verifikuar legjitimitetin e ankuesit (•), analizojmë si më poshtë.
29. Noteri (•) ka pretenduar se subjekti ankues (•) nuk gëzon legjitimim për ankim, prandaj nuk ka vend për hetim ndaj sjelljeve sipas standardeve profesionale.
30. Bordi Disiplinor i gjen të pabazuara në ligj pretendimet e Noterit dhe argumenton në kuptim të Neni 3, pika 3, e K.Pr.A. "Diskrecioni i organit publik".
31. Kjo është e drejta e këtij të fundit, për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë, duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik. Nëse ligji lejon që organi publik të vendosë për një rast, në bazë të diskrecionit, atëherë organi ka mundësinë e zgjedhjes midis opsioneve të ndryshme për të vendosur në rastin konkret. Fakti që ligji i jep kompetencë diskrecionare organit publik nuk përbën rast normal, përkundrazi ky është një përjashtim i cili duhet të gjykohet duke analizuar dispozitat e ligjit. Nëse ligji i jep organit publik kompetencë diskrecionare, ai hap në përgjithësi dy ose më shumë opsione për të vendosur mbi rastin. Organi publik duhet të vlerësojë se cilin opsion preferon dhe cili vendim duhet të merret në përputhje me rrethanat. Organi publik duhet të vendosë duke vlerësuar dhe balancuar interesat e prekura dhe duhet të marrë një vendim, i cili është në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Organi publik duhet të japë arsyet duke shpjeguar pse diskrecioni është përdorur në mënyrën përkatëse, sipas shkronjën "d", të nenit 100 KPrA.
32. Në kuptim të sa më sipër, Ministria e Drejtësisë për shkak të kuadrit ligjor dhe në veçanti për shkak të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë", neni 22 dhe 23, është organi që kontrollon veprimtarinë e notereve në RSH. Dispozitat ligjore tregojnë qartësisht organizimin e noterisë si profesion i kontrolluar nga Ministria e Drejtësisë, kjo jo vetëm për natyrën e organizimit dhe ushtrimit të këtij profesioni.
33. Parimi i diskrecionit në rastin e Ministrisë së Drejtësisë, në veprimtarinë kontrulluese të ushtruar ndaj noterëve në RSH, sipas Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë", materializohet në nenin 25, sipas të cilit Ministri i Drejtësisë, kur e sheh të nevojshme, urdhëron inspektime të posaçme për të gjitha aktet, regjistrin e veprimtarisë noteriale si dhe çdo dokumentacion tjetër të aktiviteteve noteriale, dhe në rast se gjatë një inspektimi në vend ose nëpërmjet burimeve të tjera zbulohen mangësi, noteri informohet me shkrim dhe i kërkohet që të korrigjojë mangësitë brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga Ministri i Drejtësisë hap procedurën për hetimin e shkeljes disiplinore.
34. Pamvarësisht nga sa më sipër dhe pa paragjykim ndaj tyre, për qëllime të procesit të rregullt ligjor, Ministria e Drejtësisë, në çdo rast duhet të verifikojë legjitimitetin e çdo ankuesi, që paraqet një ankesë ndaj veprimtarisë së një noteri. Në vijim, legjitimiteti në nisjen e procedurave administrative dhe vijim e tyre përpara Ministrisë së Drejtësisë, lidhet me zbatimin e rregullt të nenit 44, 65, 128 dhe 135 të KPrA, në kuptim të cilëve vetëm një palë që ka interes të ligjshëm për të mbrojtur, bëhet pjesë e procedurave administrative. Në kuptim të sa më sipër, çështja e legjitimitetit të ankuesit Pashk Noka, do të duhej të ishte trajtuar në mënyrë më të detajuar nga Ministria e Drejtësisë, në aktet që kanë shërbyer për fillimin e procedurave administrative kundër Noterit (•) dhe aktet e tjera vijuese.

### **C.2.2. Lidhur me natyrën e secilës shkelje**

35. Bordi vlerëson se shkeljet disiplinore të kryera nga noter (•), përbëjnë shkelje të natyrës së rëndë, për shkak të veprimit në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit për noterinë dhe përbëjnë veprime apo mosveprime që çënojnë rëndë besimin e publikut në sistemin noterial, konkretisht:

 **Në lidhje me mungesën e përdorimit të RNSH:**

36. VKM Nr. 304, datë 21.05.2014 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të shërbimit noterial shqiptar, regjistri noterial shqiptar (RNSH)” ka dalë për zbatim të ligjit të shfuqizuar për noterinë, Nr. 7829, datë 01.06.1994 dhe në bazë të ligjit “Për bazat e të dhënave shtetërore” Nr. 10325, datë 23.09.2010, aktualisht në fuqi.

37. VKM e mësipërme është ende në fuqi derisa nuk është miratuar një akt nënligjor (në fushën e saj të zbatimit) në kuptim të nenit 144, paragrafi 2, i Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”:

38. Regjistri Noterial Shqiptar përmban të dhënat e akteve dhe veprimeve noteriale, të dhënat e testamenteve, të dhënat e dëshmimeve të trashëgimisë, dokumentet e skanuara të akteve dhe veprimeve noteriale; të dhënat për palët, individë dhe subjekte, informacione të tjera plotësuese për procese të punës së noterëve, të dhëna referencare për ndërveprimin dhe baza të dhënash të tjera, të dhëna referencare për komunikimin ndërmjet noterëve, dhomave dhe aktorëve të tjerë, të dhënat e raporteve dhe statistika.


39. Pra, qëllimi i këtij regjistri është krijimi i bazës së të dhënave shtetërore të lidhura me veprimtarinë e noterëve, si funksionarë publik, bazë të dhënash që administrohet nga Ministria e Drejtësisë.

40. Noterët përdorin detyrimisht sistemin e RNSH-së për regjistrimin e të dhënave të parashikuara, në bazë të VKM-së si më sipër, duke pasur detyrimin që regjistrimi i të dhënave dhe hedhja e akteve, të kryhet brenda 10 ditëve nga hartimi dhe noterizimi i tyre.

41. Dështimi për të përmbushur këtë detyrim është veprim në kundërshtim me një akt nënligjor.

42. Nga faktet e procedimit disiplinor kundër Noterit (•), rezulton se për periudhën 05.10.2019 – 03.09.2021 që është një periudhë kontrolli sipas Urdhrit Nr. 644, datë 24.11.2021 të Ministrit të Drejtësisë, u konstatua se noteri ka hedhur akte deri në datën 14.09.2020. Në datën e kryerjes së hetimit disiplinor pranë zyrës së Noterit (•), datë (•), gjendja e veprimtarisë së Noterit në sistemin e RNSH, rezulton e pa regjistruar nga data (•)deri në datën (•).

43. Ky fakt nuk është mohuar gjatë procedimit disiplinor, pranë Bordit Disiplinor, por është referuar dhe provuar se Noteri (•) ka reflektuar ndaj kësaj shkelje dhe ka hedhur në RNSH të gjitha aktet e pa regjistruara në RNSH për periudhën në fjalë. Si tregues të kësaj veprimtarie Noteri (•), ka paraqitur dokumentin “Aktet/Veprimet Noteriale, për përdoruesin (•), në RNSH, për datat “(•)deri më (•)”, të cilat tregojnë për akte të regjistruara në RNSH, edhe pse jashtë afatit. Si më sipër, nuk u kundërshtua nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë.

 **Në lidhje me shkeljet në hartimin dhe çeljen procesverbalit së testamentit dhe lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare, në kuptim të neneve 111, 113, 120, 105, pika 2 të Ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe nenit 348 të Kodit Civil;**

44. Kodi Civil i RSH, në nenin 348 parashikon se “*dëshmia e trashëgimisë testamentare lëshohet nga noteri, pranë të cilit është redaktuar testamenti me akt noterial, apo është depozituar për ruajtje testamenti ollograf ose testamenti i posaçëm. Në rast se i njëjti trashëgimlënës ka lënë më shumë se një testament, dëshmia e trashëgimisë testamentare lëshohet nga noteri, pranë të cilit është redaktuar apo depozituar për ruajtje*

*testamenti i fundit*". Po ky nen parashikon se rregullat e hollësishme për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, si dhe për regjistrimin e testamenteve përcaktohen nga ligji për noterinë.

45. Në referencë të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë", neni 111 parashikon se Noteri, pasi vihet në dijeni zyrtarisht nëpërmjet një kërkesë të shkruar nga personat e interesuar për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, kontrollon kompetencën vendore të tij dhe dërgon një kërkesë pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë.
46. Pas marrjes së kërkesës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, brenda 3 ditëve, kontrollon në Regjistrin Kombëtar të Testamenteve dhe Regjistrin Kombëtar të Dëshmive të Trashëgimisë nëse trashëgimlënësi ka lënë një testament dhe/ose është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore apo testamentare nga ndonjë noter tjetër. Brenda 3 ditëve pas marrjes së përgjigjes nga Dhoma, noteri:
  - a) drejton personin e interesuar te noteri, i cili ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë ose pranë të cilit është hartuar testamenti, nëse ka;
  - b) procedon me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore ose testamentare, në përputhje me parashikimet e Kodit Civil, dhe e regjistron atë në Regjistrin Kombëtar të Dëshmive të Trashëgimisë.
47. Ne vijim, sipas nenit 113 të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë" përcaktohet se brenda 3 ditëve nga përgjigja e ardhur nga Dhoma, noteri:
  - a) informon personin e interesuar për përgjigjen e ardhur nga Dhoma dhe e adreson atë pranë noterit, i cili ka kompetencën për lëshimin e dëshmisë;
  - b) procedon me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore ose testamentare, në përputhje me parashikimet e Kodit Civil, duke bërë regjistrimet përkatëse.
48. Sipas nenit 118 të Ligjit nr. 110/2018, testamenti me akt noterial çelet nga noteri që e ka hartuar mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga trashëgimtari testamentar/ligjor ose personi i interesuar. Trashëgimtari testamentar, ligjor apo personi i interesuar, duhet të paraqesë para noterit kërkesën, çertifikatën e vdekjes së trashëgimlënësit dhe dokumentin identifikues të kërkuarit. Noteri harton procesverbalin e çeljes së testamentit në të gjitha rastet, edhe kur nuk do të procedojë me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë.
49. Neni 120 i Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë", parashikon procedurat e lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë kur ka më shumë se një testament. Kështu, sipas këtij neni, kur testatori ka lënë më shumë se sa një testament në noterë të ndryshëm, secili noter, mbi bazën e kërkesës së trashëgimtarit testamentar/ligjor ose personit të interesuar, duhet detyrimisht të hartojë procesverbalin e çeljes së testamentit.
50. Të gjitha testamentet duhet të çelen nëpërmjet procesverbalit, për të proceduar me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare, vendim të cilin e jep noteri që ka hartuar ose tek i cili është depozituar testamenti i fundit i trashëgimlënësit.
51. Një kopje e procesverbalit të çeljes së testamentit të secilit noter i jepet kërkuarit, i cili duhet ta paraqesë atë te noteri që ka hartuar apo ku është depozituar testamenti i fundit dhe që do të lëshojë dëshminë e trashëgimisë, sipas parashikimeve të Kodit Civil. Noteri që ka hartuar ose ku është depozituar testamenti i fundit pasqyron te pjesa arsyetuese procesverbalet e çeljeve të testamenteve, duke cituar pasurinë dhe trashëgimtarin, për të mos u mbivendosur dëshmia e fundit testamentare mbi pasuritë, për të cilat nuk janë lëshuar dëshmitë testamentare, dhe në fund të dispozitivit përcakton gjithë rrethin e trashëgimtarëve testamentarë, sipas procesverbaleve të çeljes, pasurinë dhe pjesët takuese.
52. Noteri, i cili ka hartuar ose pranë të cilit është depozituar testamenti i fundit i trashëgimlënësit, kur konstaton se njëri nga testamentet e mëparshme është pjesërisht ose tërësisht i pavlefshëm, e deklaron atë të tillë dhe

lëshon dëshminë e trashëgimisë testamentare për pjesën e vlefshme të këtij testamenti, nëse janë kushtet e pavlefshmërisë së pjesëshme, si dhe lëshon dëshminë e trashëgimisë testamentare për testamentet e tjera. Në rastin kur janë hartuar dy testamente dhe testamenti i dytë deklarohet i pavlefshëm, noteri që ka hartuar testamentin e parë kryen procedurat për çeljen e testamentit dhe vijon me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë.

53. Në vijm të argumentimit ligjor si më sipër dhe në ballafaqim të fakteve të konstatuara gjatë hetimit disiplinor, rezulton se noteri (•) ka vepruar në kundërshtim me parashikimet ligjore detyruese, rregulluese për veprimtarinë e tij. Kështu, ai ka çelur procesverbalin e testamentit të parë dhe ka lëshuar dëshminë përkatëse testamentare, pa kontrolluar nëse kishte testamente të tjerë dhe pa kryer procedurat për kalimin e testamentit të çelur nga ai, tek noteri ku ishte depozituar testamenti i fundit me qëllimin që procedurat për çeljen e procesverbalit të testamentit dhe lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë të kalonin në një analizë verifikuese të hollësishme.
54. Qëllimi i dispozitave të mësipërme lidhet me krijimin e stabilitetit në marrëdhëniet *inter vivos* për shkak të *causa mortis* të trashëgimlënësit. Ndjekja e një rendi të caktuar procedurash siguron zbatim të saktë jo vetëm të ligjit por edhe të testamentit, pra vullnetit të trashëgimlënësit.
55. Vullneti i trashëgimlënësit, i shprehur në formën dhe mënyrën e caktuar nga ligji, është i detyrueshëm për zbatim pas vdekjes së tij. Ky vullnet shprehet në një akt që quhet testament. Testamenti, referuar parashikimeve të Kodit Civil, është një veprim juridik i njëanshëm i kryer nga vetë trashëgimlënësi, përmes të cilit trashëgimlënësi me vullnetin e tij të lirë përcakton destinacionin që do të ketë pasuria që ai ka pasur në gjallërinë e tij, në kohën pas vdekjes. Megjithatë, vullneti i testatorit nuk është tërësisht i pakufizuar. Janë normat ligjore ato që përcaktojnë dhe kufijtë e shtrirjes së vullnetit. Që ligji t'i njohë pasoja juridike vullnetit të trashëgimlënësit është e nevojshme që ky vullnet të jetë në përputhje me normat ligjore. Në kushtet kur vullneti nuk është në përputhje me ligjin efekti që vjen është pavlefshmëria absolute apo relative e testamentit, në varësi të shkallës së cënimit të normave juridike.
56. Thënë sa më sipër, nëse analizojmë tre testamentet e lëna nga trashëgimlënësi (•). Sipas Ministrisë së Drejtësisë, nga verifikimet e bëra në Regjistrin Noterial Shqiptar (RNSH), më (•), rezulton se i ndjeri (•) ka lënë testament në 3 (tre) noterë. Po ashtu vetë Noteri (•) ka sjellë përpara Bordit Disiplinor, këto tre testamente, të cilat përmbliidhen si më poshtë:
- tek noteri (•), më datë (•) (nje pasuri të paluajtshme: ndertese: i lihet djalit të tij (•))
  - tek noteri (•), më datë (•) (tre pasuri të paluajtshme: apartament; truall dhe ndertese dhe njesi: i lihen nipit të tij (•));
  - tek noteria (•), më datë (•) (nje pasuri të paluajtshme: toke are: i lihet nipit të tij (•) dhe me çdo pasuri tjetër do të ndahet mes trashëgimtarëve ligjorë në pjesë të barabartë).
57. Duke qënë se noterja (•) është kompetente për kryerjen e veprimeve paraprahe, atyre të gjykimit të themelit në lidhje me këto testamente, gjykimin në lidhje më përputhshmërinë me ligjin dhe vlerësimin e rasteve apo shkaqeve të pavlefshmërisë, deri në lëshimin e aktit final të dëshmisë testamentare dhe asaj ligjore (nëse do të ishte rasti), vërejmë se veprimet e Noterit (•) kanë ndërprerë të gjithë zinxhirin e vlerësimit të ligjshmërisë së këtyre akteve.
58. Profesionin e noterit është një funksion me karakter publik, i cili duhet të garantojë sigurinë e transaksioneve juridike, në interesin primar të shtetit të së drejtës si dhe në shërbim të personave fizikë dhe juridikë, të cilët duhet të mund t'i drejtohen në mënyrë të sigurtë zyrave noteriale për kryerjen e shërbimeve të kërkuara, që në rastin konkret nuk ka ndodhur.

59. Sa më sipër është pranuar nga Noteri (•), si një shkelje e procedurave dhe parashikimeve urdhëruese ligjore prej tij, por në çdo rast është konsideruar si një shkelje jo shumë e rëndë, ose të paktën jo e tillë sa të jetë i zbatueshëm parashikimi i nenit 26, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, paragrafi 2, gërma dh).
60. Noteri ka refuzuar të pranojë, se aktet e përgatitura prej tij janë në mungesë të akteve bashkëlidhur dhe detyruese si shoqëruese (çertifikata, kopje të dokumentit të identifikimit), pasi këto akte kanë qënë në arkivë, por prej tij nuk janë kopjuar dhe nuk janë dorëzuar tek grupi hetimor i Ministrisë së Drejtësisë, pasi janë konsideruar pa rëndësi për qëllimin që kërkoheshin.

**🚩 Në lidhje më dështimin për t’u përgjigjur me shkrim kërkuesit Pashk Noka, në kuptim të nenit 97 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”**

61. Përtej parashikimeve ligjore si më sipër cituar, nenet 118 dhe 120 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, vlen të sjellim në vëmendje edhe parashikimin e nenit 121, që jep përkufizimin e personave të interesuar dhe interesit të ligjshëm, duke specifikuar se kanë të drejtë të kërkojnë lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë trashëgimtarët testamentarë, ligjorë dhe personat e interesuar të çmuar si të tillë nga noteri, pas një kërkesë me shkrim të arsyetuar.
62. Janë persona të interesuar çdo person fizik ose juridik, ose përfaqësues i tij, që pas vdekjes së trashëgimlënësit provojnë se kanë një interes të ligjshëm për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë. Me persona të interesuar kuptojmë institucionet publike apo private, përmbartësit që kanë një procedurë ekzekutimi të detyrimit, institucionet gjyqësore, ose çdo individ apo subjekt fizik ose juridik, ose përfaqësuesi i tij, të cilët, pas vdekjes së trashëgimlënësit, provojnë, nëpërmjet paraqitjes së një kërkesë arsyetuese, se kanë një interes të ligjshëm për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë apo çeljen e procesverbalit të testamentit.
63. Interesi i ligjshëm i çdo personi fizik ose juridik për lëshimin e një dëshmie trashëgimie duhet të bazohet në një vendim gjyqësor të formës së prerë, vendim për ekzekutimin e detyrimit, ose në një shkresë që gjykata ia drejton noterit, apo nëpërmjet një shkrese lëshuar nga gjykata që deklaron/provon procesin gjyqësor me palë trashëgimlënësin, si dhe nëpërmjet një padie të depozituar në gjykatë me shënimin e depozitimit të padisë dhe një ekzemplar origjinal të saj, si edhe në çdo rast tjetër që interesi i ligjshëm vlerësohet nga noteri.
64. Ishte detyrë e noterit (•) të verifikonte këto dy çështje dhe të procedonte me një vendim pranimit për kryerjen e veprimeve në lidhje me trashëgiminë apo një vendim refuzimi nëse vlerësonte se (•) nuk gëzonte cilësitë ligjore sipas nenit 121 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”.
65. Në çdo eventualitet, në kuptim të Nenit 63 dhe të Nenit 97 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, Noteri duhet të dilte me një vendim të shkruar. Noteri është organ publik dhe veprimtaria e tij çertifikohet përmes lëshimit të akteve administrative individuale, që janë shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete. Akte administrative janë gjithmonë në shqip dhe të shkruara.
66. Sipas Nenit 63, gërma gj) dhe Nenit 97 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, noteri refuzon hartimin e aktit, ose kryerjen e çdo veprimi noterial, përmbajtja e të cilit bie në kundërshtim të hapur me kërkesat e ligjit. Refuzimi bëhet me vendim të arsyetuar të noterit dhe i njoftohet të interesuarit brenda pesë ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës për hartimin e aktit. Personave që u është refuzuar shërbimi noterial, brenda një muaji nga dita e njoftimit të këtij refuzimi me shkrim, mund të ankohen në gjykatën administrative të shkallës së parë në territorin e së cilës vepron zyra noteriale. Përveç padive të përcaktuara në nenin 46, të Kodit të Procedurës Civile, ndaj çdo veprimi ose vendimi të noterit për lëshimin, refuzimin e lëshimit, ndreqjen e

gabimeve, ndryshimin e dëshmisë së trashëgimisë, mund të bëhet ankim në gjykatë, sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

67. Për sa më sipër, veprimet e Noterit (•), janë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe njëkohësisht mungesa e përgjigjes, ka mohuar potencialisht të drejtën e qytetarit (•) për të realizuar të drejtat e pretenduara në gjykatë.

### **C.2.3. Lidhur me caktimin e masës disiplinore në rastin konkret**

68. Sipas nenit 26 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, paragrafi 1, parashikon se masa disiplinore e dhënë ndaj një noteri jepet në proporcion me shkeljen dhe bazohet në kriteret e mëposhtme:

- a) shkallën e pakujdesisë;
- b) shpeshtësinë e kryerjes së gabimit;
- c) probabilitetin dhe rëndesën e dëmit të mundshëm nga shkelja;
- ç) çdo situatë që është jashtë kontrollit të noterit dhe që mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme.

69. Paraprakisht, vlen të theksohet se noteri është zyrtar publik<sup>2</sup>, të cilit shteti i ka deleguar kompetencën e tij duke i lejuar të vërtetojë autenticitetin dhe ligjshmërinë e dokumentave që ai harton apo që i paraqiten, për të siguruar ruajtjen e tyre dhe për tu dhënë atyre fuqi provuese e për ti bërë të zbatueshme. Për këtë shkak, noteri gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, duhet të mbajë në konsideratë detyrimet e parashikuara nga legjislacioni i zbatueshëm për një funksionar publik – si ligjshmëria, besnikëria, integriteti etj.

70. Si funksionar publik dhe njëkohësisht zbatues, praktikues i ligjit, noteri duhet të ushtrojë veprimtarinë e tij në përputhje me kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e noterisë dhe aktet nënligjore. Noteri duhet të ketë kontroll të plotë të akteve që harton, për të garantuar ligjshmëri të këtyre akteve dhe njëkohësisht për të ofruar shërbimin në mënyrë të pavarur, të paanshme, të ligjshme dhe të përgjegjshme.

### **C.2.4. Në lidhje me shkallën e pakujdesisë gjatë kryerjes së detyrës**

71. Vërehet së shkalla e pakujdesisë gjatë kryerjes së detyrës, në mënyrë të veçantë sa i përket shkeljes së dispozitave ligjore mbi çeljen e testamentit dhe lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, është në formën e pakujdesisë së rëndë. Ndërkohë, sikurse është pranuar edhe vetë subjekti i procedimit, edhe veprimtaria e Noterit (•) për regjistrimin e akteve në RNSH është në kundërshtim me dispozitat ligjore (konkretisht, VKM Nr. 304, datë 21.05.2014 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të shërbimit noterial shqiptar, regjistri noterial shqiptar (RNSH)”, nenet 111, 113, 118 120, 105, pika 2 të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, nenit 348 të Kodit Civil).

72. Megjithatë, në vlerësimin e shkallës së pakujdesisë në regjistrimin e akteve në RNSH, Bordi bën një analizë gjithëpërfshirë dhe merr në konsideratë edhe faktin e rregullshmërisë së mbajtjes së regjistrave fizikë, sikurse pranuar edhe nga Ministria e Drejtësisë, dhe hedhjes së akteve në regjistrin NISA, vetëkorrigjimin e gabimit duke hedhur në sistem pas kontrollit të ushtruar të të gjitha aktet munguese, si dhe faktin që edhe Ministria e Drejtësisë nuk e konsideron këtë fakt të vetëm si shkelje të mjaftueshme për një masë disiplinore të rëndë si ato të parashikuara nga neni 26, germat “d” dhe “dh” të Ligjit.

<sup>2</sup> Neni 1 dhe 4 i Ligjit Nr.110/2018 “Për Noterinë”.

73. Në lidhje me shkeljen e nenit 97 të Ligjit Nr. 110/2018 "Për noterinë", edhe pse Noteri parashtrohet se (•), nuk ka legjitimim e për pasojë nuk ka detyrimin t'i kthejë përgjigje, është argumentuar se qëndron krejt e kundërta. Edhe në këtë rast, noteri ka detyrimin të japë një vendim në formë të shkruar duke argumentuar shkaqet e refuzimit të veprimit të tij.

#### **C.2.5. Në lidhje me shpeshtësinë e kryerjes së gabimit**

74. Në lidhje me shpeshtësinë e kryerjes së gabimit, vërehet se Raporti Hetimor nuk ka kryer një hetim më të thelluar sesa aktet, rasti, në fjalë dhe në këtë mënyrë Bordi Disiplinor është në pamundësi për të vlerësuar këtë element në caktimin e masës disiplinore, që rrjedhimisht nuk do të rëndojë pozitën e Noterit.

75. Për sa më sipër, vërehet se ka një mungesë konsekuente në konstatimet e raportit të grupit të inspektimit dhe në përcaktimin e sjelljes me natyrë të rregullt dhe shkeljes me natyrë shkelje, duke ju referuar një herë njëherë sjellje dhe njëherë tjetër. Do të kishte qënë më e lehtë për grupin e inspektimit që të kishte inspektuar dhe konstatuar sjelljen me natyrën e shkeljes ligjore, nëse do të vërehej më shumë se një praktikë në fushë e marrëdhënieve të trashëgimisë, me qëllim që të evidentohet nëse shkelja ishte sistematike ose e vazhdueshme. Për rrjedhojë, edhe për Bordin Disiplinor do të ishte më e qartë të konstatonte nëse shkelja e noterit përbën një sjellje profesionale të vazhdueshme dhe të pranishme në disa ose shumë praktika të lidhura me çeljen e trashëgimisë testamentare ose ligjore apo është një rast i shkëputur që mund të klasifikohet edhe si një pakujdesi ligjore.

#### **C.2.6. Në lidhje me probabilitetin dhe rëndesën e dëmit të mundshëm nga shkelja**

76. Në lidhje me probabilitetin dhe rëndesën e dëmit të mundshëm nga shkelja, është me vend të sjellim në vëmendje se vlerësimi i Bordit Disiplinor në këtë rast lidhet me "probabilitetin". Pra, sa e mundur është që nëse veprimtaria e Noterit, kryhet apo vijon të kryhet në këtë mënyrë, shkakton apo do të shkaktojë dëme.

77. Hartimi i akteve të pavlefshëm apo që mund të krijojnë probabilitet për akte të pavlefshme, përbën jo vetëm pasojë të rëndë të një veprimtarie në kundërshtim me ligjin, por pa asnjë dyshim edhe cënim të imazhit të noterisë dhe të shtetit të së drejtës gjithashtu, në kushtet që noteri është funksionar publik.

78. Noteri (•) nuk ka përmbushur kërkesat ligjore lidhur me mënyrën e veprimit të duhur ligjor, në drejtim të çeljes së testamentit dhe lëshimit të dëshmisë testamentare. Konstatohet se noteri nuk ka plotësuar kërkesën kryesore për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë. Konkretisht nuk ka dërguar një kërkesë pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë, për të verifikuar nëse trashëgimlënësi ka lëshuar testament apo ka dëshmi tjetër trashëgimie të regjistruar. Procedura e lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë kur ka më shumë se një testament është e tillë që në rastet kur testatori ka lënë më shumë se sa një testament në noterë të ndryshëm, secili noter, mbi bazën e kërkesës së trashëgimtarit testamentar/ligjor ose personit të interesuar, duhet detyrimisht të hartojë procesverbalin e çeljes së testamentit. Të gjitha testamentet duhet të çelen nëpërmjet procesverbalit, për të proceduar me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare, vendim të cilin e jep noteri që ka hartuar ose tek i cili është depozituar testamenti i fundit i trashëgimlënësit.

79. (•)ka lënë testament në 3 (tre) noterë. Noteri (•) ka sjellë përpara Bordit Disiplinor, këto tre teste, të cilat përmbliken si më poshtë:

- tek noteri (•), më datë (•) (një pasuri të paluajtshme: ndërtesë: i lihet djalit të tij (•))
- tek noteri (•), më datë (•) (tre pasuri të paluajtshme: apartament; truall dhe ndërtesë dhe njësi: i lihen nipit të tij (•));
- tek noteria (•), më datë (•) (një pasuri të paluajtshme: tokë arë: i lihen nipit të tij (•) dhe cdo pronë tjetër e luajtshme apo e paluajtshme që do të rezultojnë së janë në pronësi të tij, të gjitha pronat apo

*çdo pjesë takuese respektive, që do ti përkasi ligjërishit, prona të fituara me trashëgimi apo në çdo rrugë tjetër ligjore si dhe çdo shumë të depozituar në emrin e tij, do të ndahet mes trashëgimtarëve ligjore në pjesë të barabartë)*

80. Duket sikur testamenti i tretë ndryshon mënyrën e disponimit të trashëgimlënës, por në çdo eventualitet veprimtaria e Noterit (•) i ka ndërprerë rrugën shqyrtimit dhe vlerësimit të dy testamenteve vijuese, nga noterja kompetente. Në këto kushte vlerësohet se probabiliteti dhe rëndesa e dëmit të mundshëm nga shkelja e kryer nga Noter (•) është mëse e mundshme për tu verifikuar apo ndodhur në të ardhmen.
81. Edhe pse Noteri (•) pretendoi se nga veprimtaria e tij nuk ka dëme, përveç deklarimit nuk arriti të provojë me tej. Edhe sikur kjo të ndodhte, mënyra e veprimit të tij është dhe mbetet një rrezik potencial, pasi është në kundërshtim me parashikimet ligjore të drejtpërdrejta dhe shteruese. Kjo do të thotë se probabiliteti dhe rëndesa e dëmit nga shkelja janë në përqindjen dhe masën maksimale të ndodhjes së tyre.
82. Duket sikur në pamje të parë nuk ka dëm të specifikuar në mënyrë konkrete dhe të drejtpërdrejtë me natyrë pasurore. Në fakt, nuk ka një vlerësim të masës së dëmit nga palët e interesuara ose nga grupi i inspektimit, nuk ka një evidentim të llojit të dëmit apo një ekuivalentim të tij në kriteret sasiore dhe pasurore. Megjithatë, në çdo rast, një cënim i dispozitave ligjore në atë shkallë sa të sjell një probabilitet të mjaftueshëm në cenimin e të drejtave pasurore që lidhen me trashëgiminë për një person konkret e bën dëmin të mbetet eminent, ndonëse nuk është pretenduar nga ndonjë palë e dëmtuar.
83. Mbetet gjithmonë fakti se dëmi i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm pasjell përgjegjësi civile për dëmshpërblim dhe, për rrjedhojë, edhe përgjegjësi administrative, por fakti që asnjë palë e interesuar nuk ka pretenduar një dëm konkret dhe real na çon në konkluzionin se shkelja mbetet në herarkinë e një shkelje të rëndë, por jo shumë të rëndë. Kështu, për të përzgjedhur masën e duhur administrative që i korrespondon kësaj shkelje, Bordi Disiplinor vlerëson për të mos shkuar në limitin maksimal të masës që do t'i korrespondonte në mënyrë proporcionale vetëm një shkelje shumë të rëndë.

#### **C.2.7. Në lidhje me çdo situatë që është jashtë kontrollit të noterit dhe që mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme.**

84. Në rastin konkret të Noterit (•), nuk ka asnjë situatë jashtë kontrollit të tij që të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme. Noteri ka marrë vendim që të kryejë veprimtari në kundërshtim e në shkelje me ligjin.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Bordi Disiplinor i Dhoma Kombëtare e Noterisë, mbështetur në nenin 51 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë” dhe nenin 11 të Udhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 170 datë 10.06.2020 “Për miratimin e rregullores dhe skemën e kompesimit dhe funksionimin e Bordit Disiplinor”,

#### **VENDOSI:**

1. Pranimin e kërkesës të Ministrisë së Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj Noter (•) dhe marrjen e masave disiplinore si më poshtë:
  - Pezullimin nga detyra të noterit (•), për një periudhë 18 (tetëmbëdhjetë) muaj;



- Detyrimin e Noterit (•) që të ndjekë programin e trajnimit të detyruar vjetor pranë Qendrës Shqiptare të Trajnimit të Noterëve, si dhe të ndjekë një program të personalizuar 12 (dymbëdhjetë) ditor, në fushën e trashëgimisë.
- 2. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për nxjerrjen e urdhrit përkatës për zbatimin e këtij vendimi, duke parashikuar modalitetet për zbatimin e tij;
- 3. Ngarkohet Dhoma Kombëtare e Noterisë, që në kuptim të nenit 54 dhe 55 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, të bëjë publikimin e këtij vendimi dhe ta rregjistrojë atë në regjistrin e masave disiplinore.
- 4. Ngarkohet Dhoma Kombëtare e Noterisë që në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare të Trajnimit të Noterëve, të ndjekë zbatimin e këtij vendimi në lidhje me ndjekjen e programit të trajnimit të detyruar vjetor dhe atij të personalizuar, për Noterin (•).
- 5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë, brenda 45 diteve nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi.

U shpall më datë (•), në Tiranë.

### **Bordi Disiplinor**

**Jonida Gaba**  
**KRYETARE**

**Entela Memishaj Shehaj**  
**SEKRETARE**